


Flora e Dibrës



Informacioni: Dibër konsiderohet një nga vendet më të pasura në bimësi si në lloje edhe në shtrirje. Nga drurët më të përhapur rriten: Arneni (*Pinus peuce Gris*) që takohet në majën e Runjës, Kunorën e Lurës dhe Manazdre; Pisha e Zezë (*Pinus nigra Azm*) takohet në Lurë, Bulqizë dhe Tërnovë; Robulli (*Pinus Heldreichii Crist*) është hasur në Korab dhe Lurë; Dëllinja e Zezë (*Juniperus Comuni L*) rritet mirë në lartësinë e Korabit, në Lurë, dhe në malet e Zerqanit - nga kokrrat e dël-lenjës bëhen pije alkolike, nxiren esencat për liqernat, barëra e shërupe mjekësore kundër sëmundjes së frymëmarjes; Bërzheni (*Juniperus foetidissima ëillt*) rritet në Lurë; Bliri (*Tilia L*) rritet kudo - Shetitortja "Elez Isufi" në të dy anët ka blira. Gjithashtu në Dibër rritet mirë Ahu (*Fagus silvatica L*), Verrini (*Alnus Gaertn*), Mështekna (*Betula Verrusa Ehrh*), Shtogu i Zi (*Sambucus nigra L*), Vidhni (*Ulmus faliacea Gilib*), Shelgu i bardhë (*Salix alba L*), dhe Plepi i bardhë (*Populus alba L*).



E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Parku Kombëtar i Lurës



Vendodhja: Në përfundim të Peshkopisë

Përshkrimi: Parku është i pasur me një flora dhe fauna të veçantë të rajonit të Dibrës. Parku ngrihet në lartësinë 1375-1919m mbi nivelin e detit dhe shtrihet në faqen lindore të masivit Kurora e Lurës. Lura ka një sipërfaqe 1280ha, nga e cila 1100ha pyje, 50ha livadhe, dhe 30ha pasqyra e ujit të liqeneve. Pikat specifike që duhet të vizitohen brenda parkut përfshihen, Fusha e Pelave dhe liqenet që quhen "shtatë sy të kaltër, me qerpik të gjelbër" të Lurës.

Drejtimi nga Peshkopia: Nisesh në përfundim të qytetit, duke marrë rrugën kryesore, tek kryqëzimi kthehesh majtas, vazhdon drejt rrugës kryesore deri në Muhurr, pastaj vazhdon rrugën djathtas drejt fshatit Vajmëdhej, kalon këtë fshat duke vazhduar drejt rrugës kryesore për në fshatin Arras, kalon urën e Setes, ecen djathtas drejt fshatit Çidhën, në të dale të Cidhnës ecën përsëri djathtas për Grykë Noka, për të dale nga Grykë Noka duhet të marrësh rrugën djathtas sipër fshatit Grykë Nokë për të vazhduar rrugën kryesore për në Lan Lurë, dhe në Lurë. Për të shkuar tek liqenet, nisesh nga Hoteli i Lurës, është rruga kryesore e fshatit, shkon djathtas dhe ngjitesh sipër rrugës ku të çojnë tek Liqenet.



E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Kisha e Shën Mitrit



Vendodhja: Fshati Kërçisht

Pershkrimi: Kisha e Shën Mitrit është ndërtuar nga muratorë vendas në vitin 1892 me gurë e llaç gëlqerje. Çatia ka konstrukt druri të mbuluar me rrasa guri. Tavani është zbukuruar me afreske. Si kulturë anon nga kultura bizantine. Në vitin 2007 është shpallur monument kulture.

Drejtimi nga Peshkopia: Rruga në lindje të Peshkopisë, është segmenti Peshkopi-Maqellarë, në qendër të Maqellarës kthen djathtas ku janë dy rrugë, merr rrugën në të djathtë që të çon në fshatin Kërçisht i Poshtëm dhe vazhdon drejt rrugës që lidh dy fshatrat për në Kërçisht të Eperm.



E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Bimë Mjeksore dhe Aromatike



Informacioni: Dibra është shumë e pasur në bimë mjeksore dhe aromatike, 80 lloje të ndryshme të cila gjënden, mbliidhen, dhe për punohen në rajon. Këta lloje përfshihen Sherbela (*Salvia officinalis*), Agulice (*Primula*), Murrizi (*Orataegus monogyna*), Dëllinja e Zezë (*Juniperus communis*), Dëllinja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Trandafili i egër (*Rosa canina*), Bishtkali (*Equisetum arvense*), Hithra (*Urtica dioica*), Thundër mushka (*Tussilago farfara*), dhe Molla e egër (*Malus sylvestria*). Të gjitha bimët mjeksore dhe aromatike të Dibrës i përkasin florës spontane dhe janë prodhime të pastra natyrale. Mbas përpunimeve, këta bimë tregëtohen në vende të ndryshme të BE si në Gjermani, Spanjë, Francë, Greqi, Itali; gjithashtu dhe në Sh.B.A.




E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Shpellat të Dibrës



Informacioni: Shpellat e shumta të Dibrës janë një risi tjetër e kësaj treve, që janë shfrytëzuar që nga njeriu primitiv e deri në mesjetën e hershme. Shpellat më të rëndësishme konsiderohen Shpella e Skënderbeut në Reç, Shpella e Bellovës, Shpella e Borovës, e Nazirit në Mat, Shpella e Radit (ku kanë qenë gjetur objekte prehistorike), Shpella e Ostrenit të Madh, Shpella e Sharakanit në Komunën Muhurr, Shpella e Pëllumbit afër Kastriotit, Pirra e Madhe në fshatin Fshat, Shpella e Gaqit dhe e Kamës së Atit në Shkinak, të cilat ndodhen në fshatin Hotesh të komunës së Luznisë, buzë Drinit të Zi, që nga banorët vendas thirren "Shpella e Kllogjerit". Shpella e Gjurasit në Komunën e Shupenzës është gjithashtu interesante. Për të cilën banorët vendas thonë se kanë gjetur eshtra të "njeriut të lashtë" atje.




E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Bletaria e Dibrës



Informacioni: Që në lashtësinë e hershme dibranet kanë treguar interes për bletarinë dhe kanë zhvilluar profesionin nëpër vite. Mjalti i vendit vjen në shumë varietete, kjo për shkak se kosheret e bletëve janë të vendosura në vende të ndryshme, në të cilat bletët ushqehen, si për shembull në bjeshkë, pemtore qershie, akacie, gështenje dhe në fusha. Këto lloje mjalti mund të gjeni në dyqane edhe në tregun e së dieles. Sot në rrethin e Peshkopisë numërohen pothuajse 400 bletar që mund të kenë 7000 koshere bletetësh - Maqellara, Kastrioti, Lura dhe Melani janë komunat më të zhvihuara për sa i përket bletarisë. Në vitin 2009 bletarët e Dibrës morën nga bletët 68.43 ton mjalt.



E NJOH, E DIBRËN



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Shëtitje dhe Kamping



Informacioni: : Ka shumë mundësit për shëtitje dhe kamping në Dibër pasi vendi është i pasur me rrugë këmbësore që mund të aksesohen me lehtësi. Vendet alpine të hapur krijojnë mundësi eksplorimi dhe navigimi të thjeshtë. Me përjashtim të Malit të Korabit, sistemi i rrugëve në Dibër është bazuar në udhëtimin e barinjve dhe rrugët nuk shënohen - këto në përgjithësi fillojnë në fshatra dhe shkojnë në bjeshkë. Punonjësit në Zyrën e Informacionit e Turizmit të Peshkopisë do t'ju rekomendojnë rrugët lehtësisht.



E NJOH, E DIBRËN



Fauna e Dibrës



Informacioni: Kafshët e egra dhe grabitqare në Dibër përfaqësohen nga ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Canis vulpes*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), riqebulli (*Felis silvestris*), macja e egër (*Felis silvestris*), kunadhia (*Martes martes* L), dhe vjetulla (*Martes martes* L). Kafshët e egra, dhe e shpend jo grabitqar përfaqësohen nga ketri (*Sciurus vulgaris* L), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra* L), derri i egër (*Sus scrofa*), dhe lepuri (*Lepurus europens*), . Të gjithë këto kafshë takohen në vargëmalet e Deshatit, Mali i Korabit, malet e Lurës, të Zerqanit, Homeshit dhe të Gollobordës. Në Dibër ka shumë shpend te grabitqar dhe jo grabitqar. Të parët përfaqësohen nga Shqiponja (*Gyps fulvus*), bufi ose hutini (*Bucobugo*), harabeli (*Passerus brison*), skifteri (*Falco cherrung*), sorra, dhe laraska. Në shpendët jo grabitqar hyjnë thëllënxa e malit (*Alectoris graeca meish*), thëllënxa e fushës (*Fredix predix* L), pëllumbi i egër (*Colomba oenast*), pula e egër (*Banasa bonasia*), gjeli i egër (*Tatrao urogallus* L), shkurta (*Coturni coturnix* L), dhe turtulli (*Stroptopelia tortuff*). Në vendin ku takohen Zalli i Okshtunit me Drinin e Zi janë parë rosa, pulbardha dhe rallë lejleku.



E NJOH, E DIBRËN

